



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e DISKUTIMIT PUBLIK

Për

Qarkoren-Buxhetore 2023/01 –me Këshillat e Fshatrave

Diskutimi publik është mbajtur me dt. **21.06.2022(e marte) në ora 10:00**

Vendi : Salla e Kuvendit në objektin e Komunës.

Diskutimi Publik u organizua nga Kuvendi i Komunës së Deçanit përmes grupit punues në përbërje : 1.Hajdar Sutaj,kryesues i KPF1.Hajdar Sutaj,kryesues i KPF-së me antarët e KPF-së, 2.Yllarta Thaqi, 3.Armend Loshaj, 4.Florim Mataj, 5.Hyri Dobrunaj, 6.Vatan Istrefaj dhe 7. Faton Selmanaj, ndërsa takimin e udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit dhe KPF-së, z.Hajdar Sutaj.

Ky diskutim publik ka qenë i hapur për të gjithë qytetarët e komunës së Deçanit, shoqërinë civile, gazetarët etj.

Në takim kanë marrë pjesë gjithsejt 43 pjesëmarrës (34 meshkuj dhe 9 femra), kryesisht kryetar të Këshillave Lokale të fshatrave, Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj, Drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, znj.Dafina Cacaj dhe qytetarë.

Drejtoresha e Buxhetit, znj.Dafina Cacaj, sqaron rreth Qarkpres së parë buxhetore.

Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj, ka sqaruar hollësisht për çdo planifikim buxhetor në Komunën e Deçanit që lidhet drejt për drejt me jetën dhe mirëqenien e qytetarit në Komunën tonë.

Kërkesat e qytetarëve kryesisht ishin për rregullim të infrastrukturës, kanalizim të ujrave të zeza, Ujësjellës, zhvillim të turizmit, ngritjen e Lapidarëve, asfaltim të rrugicave të fshatrave, kanale të ujitjes, etj.

Deçan, dt.21.06.2022

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

